



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.164 dt.29.09.1997

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.29.09.1997, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Komisioni i ngritur me Urdhër Nr.258, dt.14.07.1997 të Kryetarit të Bashkisë, bazuar dhe në Ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”.

VENDOSI

- I. Të përgatitet materiali për Këshill Bashkiak për pajisje me autorizim definitiv për rastet që nuk kemi konflikte si :
 1. 48 apartamente të trajtuara me Vendim të Kryetarit të Bashkisë
 2. Qytetarët që kanë autorizim sipas Vendimit Nr.125, dt.07.12.1990 të Komitetit Egzekutiv të K.P.Rrethit, dhe banojnë vetë në këto apartamente
 3. 50 apartamentet e Pallatit Nr.6 në Rr.”M.Keta” që janë me vendim të ndërmarrjes industriale (Al – Mak)
- II. Për të gjithë rastet e tjera të bëhet studimi për çdo apartament mëvete rast për rast dhe të paraqiten për tu miratuar në Këshillin Bashkiak, bazuar në V.K.M. Nr.46, dt.29.01.1993.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI

